



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA E TIRANËS
QENDRA EKONOMIKE E ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____, ____, 2019

Formular i njoftimit të fituesit

Data 08/01/2019

Për: Operatorin Ekonomik “Kadra” Sh.p.k.

Adresa : Rr. Nënë Tereza, Banesë Private me Nr.Pasurie 180/29, Zona Kadastrale 2372, Laknas, Kamëz, Tiranë

Procedura e prokurimit: **Tender i Hapur**

Numri i Referencës për Procedurën: **Loti III – “Blerje bukë thekre dhe integrale” - REF-92736-11-05-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Objekti “Blerje Ushqime” për QEZHEF ndarë me lote – **Marreveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara – me nje Operator Ekonomik fitues per çdo lot - me afat të Marrëveshjes Kuadër 12 muaj : Loti III – “Blerje bukë thekre dhe integrale” - me fond limit 14 834 173 (katërmëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa T.V.SH. Fondi i mësipërm nuk i përfshin të gjitha detyrimet fiskale si dhe T.V.SH-në.**

Publikime të mëparshme: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 45, Datë 12 Nëntor 2018**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Shoqëria “Nelsa” Sh.p.k	J71601012S
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 9 586 500 lekë pa T.V.SH.	

2. Shoqëria “Eglenti” Sh.p.k	L28405201R
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 8 939 100 lekë pa T.V.SH.	

3. Shoqëria “K A D R A” Sh.p.k

K31321008J

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 9 773 250 lekë pa T.V.SH.

4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “M.C.Catering” Sh.p.k dhe “Regli” Sh.p.k

M.C.Catering

K72218022J

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Regli

K48021206L

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur është 14 815 500 lekë pa T.V.SH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1) “Nelsa” Sh.p.k

- I.1 Kriteret e veçanta pika 2.3.5, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin që vërteton përmbushjen e plotë të këtij kriteri. Konkretisht mungon dokumentacioni që vërteton përmbushjen e kapacitetit prej 3000 bukë në ditë.
- I.2 Kriteret e veçanta pika 2.3.9, operatori ekonomik nuk ka dorëzuar mostrat sipas specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor për artikujt e kërkuar:

I.2.1 Artikulli “Bukë thekre”

Pesha e mostrës së paraqitur është 0.35 kg, ndërsa në specifikimet teknike pesha e bukës duhet të jetë 1 kg. Ka paraqitur, në origjinal, Analiza Fiziko-Kimike me Raport Prove nr. 7712/2018, datë 20.11.2018 të kryer në ISUV, ku janë analizuar vetëm dy nga 4 treguesit e kërkuar në specifikimet teknike. Nuk janë analizuar treguesit: Lagështira në %, Kripa në %.

Gjithashtu në Raport Analizën Fiziko-Kimike të paraqitur, mostra e analizuar është 700 gr dhe nuk përputhet me mostrën e paraqitur e cila është 350 gr. Raport Analiza Fiziko-Kimike e paraqitur nuk përputhet me produktin e paraqitur si mostër. Buka nuk është e prerë në feta siç kërkohet në specifikimet teknike.

I.2.2 Artikulli “Bukë integrale”

Ka paraqitur në origjinal, Analiza Fiziko-Kimike me Raport Prove nr. 7713/2018, datë 20.11.2018 të kryer në ISUV, ku janë analizuar vetëm dy nga 4 treguesit e kërkuar në specifikimet teknike. Nuk janë analizuar treguesit: lagështira në %, kripa në %. Buka nuk është e prerë në feta siç kërkohet në specifikimet teknike.

2) “Eglenti” Sh.p.k

2.1 Pas konstatimit të ofertës anomalisht të ulët, AK iu drejtua me shkresën Nr.1378/27, datë 17.12.2018 OE për justifikimin e çmimit të ofertës. OE me shkresën nr.1378/28, dt.17.12.2018 ka kthyer përgjigje brenda afateve ligjore. KVO pasi u njoh me justifikimin e ofertës nga ana e OE vendosi refuzimin e saj me arsyetimin si më poshtë: Në justifikimin e ofertës anomalisht të ulët, OE ka paraqitur vetëm analizën e kostos me preventiv për të dy artikujt e kërkuar. OE nuk ka argumentuar dhe sqaruar në mënyrë të detajuar, si dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës apo provues si: fatura tatimore apo kontrata të ngjashme me të cilat provon se ka realizuar me sukses kontrata të mëparshme me këtë ofertë anomalisht të ulët. Kontratat e ngjashme të paraqitura në sistem kanë çmim/kg më të lartë për artikullin “Bukë gruri”, ndërsa çmimi/kg në këtë procedurë është më i ulët dhe me një diferencë të konsiderueshme.

“Nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar e tillë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave”.

Gjithashtu nga dokumentacioni i paraqitur në sistem rezulton se OE ka kontratë furnizimi me “Eraldo-2013” shpk dhe nuk është prodhues, ndërsa analiza e kostos është detajuar me elementë si prodhues.

KVO vendosi të kualifikojë operatorët ekonomikë si më poshtë:

1. “**K A D R A**” Sh.p.k me ofertë ekonomike 9 773 250 lekë pa T.V.SH.
2. BO “**M.C.Catering**” Sh.p.k dhe “**Regli**” Sh.p.k me ofertë ekonomike 14 815 500 lekë pa T.V.SH.

Përsa mësipër njoftimi i klasifikimit u publikua më datë 18.12.2018.

Në afatet ligjore të parashikuara, ka pasur ankesa në Autoritetin Kontraktor nga operatori ekonomik “**Nelsa**” Sh.p.k.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: “**K A D R A**” sh.p.k, me adresë kryesore : Rr. Nënë Tereza, Banesë Private me Nr.Pasurie 180/29, Zona Kadastrale 2372, Laknas, Kamëz, Tiranë, se oferta e paraqitur, prej 9 773 250 (nëntë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa T.V.SH dhe 11 727 900 (njëmbëdhjetë milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e nëntëqind) lekë me T.V.SH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të depozitoni pranë **Autoritetit Kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve**, me adresë Rr. “ Barrikadave ”, Çerdhja Nr. 1, Tiranë, kopjen e nënshkruar te formularit te kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar), siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Klasifikimi është bërë në datë 18.12.2018.

Titullari i Autoritetit Kontraktor

Zhaneta BEQIRI

